

VENDIM
Nr. 84, datë 16.9.2014

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SHPK, NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 102, DATË 21.12.2009**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “F”, 5 pika 1 germa “F”, 12, 13, 14 pika 1 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /te pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9 pika 4/9 gerrat a,b dhe c) janë plotësuar tërësisht.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 102, datë 21.12.2009.
 2. Ky vendim hyn në fuqi më 21.12.2014 dhe i shtrinë efektet e tij për një periudhë 5-vjeçare.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti